



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 16/09/22 Ref.: 1320/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 104-të, të mbajtur më 01.09.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Nuk riakreditohen** programet e studimit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”:
1. *Gjuhësi, PhD*, 180 ECTS;
 2. *Letërsi, PhD*, 180 ECTS
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Fakulteti i Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Gjuhësi, PhD</i> , 180 ECTS, Riakreditim	Rahman Paçarizi Lindita Tahiri Bade Bajrami Isa Memishi Vjosa Hamiti
2.	<i>Letërsi, PhD</i> , 180 ECTS, Riakreditim	Nysret Krasniqi Muhamet Hamiti Valbona Berisha Nuran Muhaxheri Sali Bashota

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me këtë përbërje: Dhurata Shehri, Anca Greere dhe Giga Khositashvili. Vizitat janë organizuar në datat: 31.05.2022 dhe 02.06.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Standardet për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës, ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Gjuhësi, PhD*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush 24 standarde thelbësore dhe 9 standarde plotësuese të akreditimit.
2. Për programin e studimit *Letërsi, PhD*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush 26 standarde thelbësore dhe 10 standarde plotësuese të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 104 të mbajtur më 01.09.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Filologjisë të Universitetit, të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Ass. Dr. Nasrulla Hazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë